

BULETIN I VENDIMEVE GJYQËSORE

VOLUMI 10

(Korrik- Dhjetor 2021)

Përmbajtja

PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS ADMINISTRATIVE.....	4
1. Vendim nr.00-2020-219, datë 08.03.2021	4
2. Vendim nr. 278, datë 12.05.2021	8
3. Vendim nr.80-2021-743, datë 17.03.2021	11
4. Vendim nr. 556 (86-2021-675), datë 10.11.2021	14
5. Vendim nr. 377, datë 24.06.2021	17
6. Vendim nr. 432, datë 17.09.2021	18
7. Vendim Nr.550, datë 10.11.2021	20
8. Vendim nr. 466, datë 29.09.2021	21
9. Vendim Nr. 406, datë 14.07.2021	24
10.Vendim nr.355, datë 20.09.2021	26
11. Vendim nr. 552, datë 10.11.2021	28
12. Vendim nr.530, datë 03.11.2021	29

Në zbatim të nenit 28, të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve publikon në faqen e saj të internetit çdo gjatë muaj një buletin informues mbi vendimet e formës së prerë të Gjykatës Administrative të Apelit, të Gjykatës së Lartë dhe të Gjykatës Kushtetuese për çështjet tatimore, me qëllim informimin e tatimpaguesve dhe në bazë të të cilave, për raste të unifikuara, reflekton rast pas rasti vendimet teknike, të cilat zbatohen për raste të tjera të ngjashme.

Ky buletin përmban disa njohuri bazë mbi hapat që ndiqen nga tatimpaguesi gjatë procedurës së ankimit, si dhe përmbledhje të disa vendimeve të formës së prerë të Gjykatës Administrative të Apelit, për çështjet tatimore. Ai është hartuar me një gjuhë të thjeshtë, por duke iu përmbajtur me saktësi terminologjisë ligjore të përdorur në Ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

Informacion më të detajuar mund të gjeni në faqen tonë të internetit: <https://www.tatime.gov.al>

Qasja e lirë në legjislacionin tatimor dhe rregulloret e përditësuara, është e aksesueshme lehtësisht në linkun: <https://www.tatime.gov.al/c//legjislacioni>

Shënim!

Informacioni i paraqitur në këtë material përshkruan situatën, sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Ky legjislacion mund të jetë objekt ndryshimi apo shfuqizimi. Informacioni ka vetëm qëllim informimi dhe nuk duhet të konsiderohet si këshillim apo opinion ligjor. Për zgjidhjen e një rasti specifik kërkoni ndihmë profesionale.

PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS ADMINISTRATIVE

1. Vendim nr.00-2020-219, datë 08.03.2021

Gjykata e Lartë

Paditës: Shoqëria “K.A” sh.p.k, NIPT _____

Të paditur: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve Tiranë,
Drejtoria e Apelimit Tatimor
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër

Objekti:

- Objekt gjykimi fillimisht sipas kërkesëpadisë së komunikuar nga Gjykata “shfuqizim i njoftim vlerësimit nr. _____ Prot., datë 10.09.2012 të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër si akt absolutisht i pavlefshëm, kundërshtim i vendimit nr. ____ Prot., datë 04.01.2013 të Drejtorisë së Apelimit Tatimor.....”
- Në vijim para Gjykatës subjekti ka pretenduar “pavlefshmërinë absolute të njoftim vlerësimit tatimor nr. _____ Prot., datë 10.09.2012”

Shuma e detyrimit tatimor: 2.214.969 lekë

Përmbledhje e rrethanave të faktit:

Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër ka ushtruar kontroll në shoqërinë “K.A” sh.p.k, duke përpiluar fillimisht aktin e kontrollit datë 25.07.2012 dhe procesverbalet bashkëngjitur këtij Akti, Procesverbali nr. ____, nr. ____, nr. ____, nr. ____, nr. ____ datë 24.07.2012 .

Ky akt kontroll paraprak i është njoftuar subjektit me shkresën nr. _____ Prot., datë 03.08.2012, duke iu bërë e ditur dhe e drejta e kundërshtimit të tij brenda 5 ditëve nga marrja dijeni pranë Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër.

Njoftimi i këtij akti është bërë nëpërmjet shërbimit postar, dorëzuar akti nga organi tatimor me datën 03.08.2012 në shërbimin postar, shoqëruar me “Lajmërim marrje”, në të cilin shprehet konfirmimi i subjektit paditës për marrjen në dorëzim të praktikës së këtij kontrolli (është paraqitur para Gjykatës me vlerën e provës “Lajmërim marrje Nr.176/2”).

Në zbatim të procedurave pas përfundimit të kontrollit subjekti është njoftuar me Aktin përfundimtar të kontrollit datë 15.08.2012, komunikuar me shkresën nr. ____ prot datë 10.09.2012 së bashku me Njoftim-Vlerësimin nr. _____ Prot., datë 10.09.2012, vlerësuar pas hedhjes së të dhënave të aktit të kontrollit në sistemin informatik të organit tatimor.

Kontrolli është ushtruar mbi bazën e një Autorizimi për kryerje kontrolli nr.____ Prot., datë 02.07.2012, Njoftimi për kontroll nr.____ prot datë 03.07.2012, të nënshkruar nga vetë subjekti dhe Programi për kontroll sipas të cilit subjekti do të kontrollohej për tatim fitimi viti 2008, 2009, 2010, 2011, tatimin mbi vlerën e shtuar dhe sigurime shoqërore dhe shëndetësore për periudhën 2008/11 – 2012/06.

Subjekti është njoftuar me Aktin përfundimtar të kontrollit, komunikuar me shkresën nr.____Prot., datë 10.09.2012 dhe njoftim-vlerësimin nr.____ Prot., datë 10.09.2012.

Subjekti duke mos qenë dakord me këtë vlerësim i është drejtuar Drejtorisë së Apelit Tatimor, me një kërkesë ankimore në lidhje me këtë njoftim vlerësim.

Kjo Drejtori është përgjegjës me vendimin e saj nr.____ Prot., datë 04.01.2013, adresuar subjektit dhe Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër, nëpërmjet të cilit vendos:

Refuzimin e ankimit në lidhje me anulimin e detyrimeve tatimore të përcaktuara në aktin administrativ, njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore nr.____ Prot., datë 10.09.2012 të DRT-Shkodër, bazuar në rezultatet e Raport kontrollit për shkak se e konsideron atë të papranueshëm, pasi nuk është vërtetuar pagesa e plotë e detyrimit tatimor.

Pra, nga subjekti nuk ishin plotësuar kërkesat ligjore për marrjen në shqyrtim të kërkesës së tij ankimore, kërkesa këto të përcaktuara në ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër nëpërmjet vendimit të saj nr.2001 (3673) datë 23.09.2013, ka vendosur:

- Rrëzimin e kërkesëpadisë

- Gjykata e Apelit Shkodër me vendimin nr. 422, datë 20.01.2014, ka vendosur :

- "Moskompetencën e Gjykatës së Apelit Shkodër dhe dërgimin e çështjes për kompetencë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë"

- Mbi bazën e ankimit të palës paditëse çështja është shqyrtuar nga Gjykata Administrative e Apelit, e cila me vendimin e saj nr.1769, datë 13.05.2014, ka vendosur:

- Prishjen e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe pushimin e gjykimit të çështjes.

- Kundër vendimit lejohet Rekurs në Gjykatën e Lartë.

Gjykata Administrative e Apelit mban në konsideratë vendimin unifikues nr.3, datë 12.02.2008 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, pika 38.03:

“... nëse pretendohet pavlefshmëria absolute e akteve, kërkimi që nuk është i ndërruarur nga ndonjë afat parashkrimi, gjykata nuk mund të nxjerrë çështjen jashtë juridiksionit gjyqësor por në zbatim të nenit 121 të K.Pr.Administrative dhe 331 të K.P.C konstaton pavlefshmërinë për efekt të zgjidhjes së pasojave juridike që janë krijuar nga akti”.

Sipas praktikës së Gjykatës së Lartë është konsoliduar qëndrimi se, nëse me anë të padisë kërkohet pavlefshmëria absolute e aktit administrativ nuk është e detyrueshme të ezaurohet më parë rruga administrative e ankimit. Në këtë rast objekt i gjykimit konsiston në vërtetimin jo të njërit prej shkaqeve të parashikuara shprehimisht nga ligji për nulitetin e aktit administrativ pasi, sipas nenit 117 të Kodit të Procedurave Administrative secila palë e interesuar mund të kërkojë që akti administrativ të shpallet absolutisht i pavlefshëm.

Aktet administrative absolutisht të pavlefshme për shkak të shkeljes thelbësore nuk kanë fuqinë juridike të një akti të vlefshëm dhe objektivisht konsiderohen se nuk kanë ekzistuar për asnjë çast. Akti që në momentin e nxjerrjes nuk krijon dhe as mund të krijojë pasojat juridike, për sa është nxjerrë dhe ai është një nulitet që nuk ka hyrë kurrë në fuqi. Referuar nenit 121/2 të Kodit të Procedurave Administrative sipas të cilit shprehimisht thuhet, se organi administrativ nuk ka të drejtë të shfuqizojë apo revokojë aktet administrative absolutisht të pavlefshme atëherë në rastin kur kërkohet pavlefshmëria e aktit nuk është e nevojshme të ndiqet me parë rruga administrative e ankimit, pasi kur kërkohet pavlefshmëria absolute e aktit administrativ gjykata nuk shqyrton thelbin e aktit, por mjaftohet me verifikimin e kërkesave të nenit 116 të Kodit të Procedurave Administrative.

Me vendimin nr.00-2013-2570 (33), datë 26.12.2013, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka mbajtur qëndrim:

“ ... është vendi të ritheksojë qëndrimin tashmë të konsoliduar në praktikën gjyqësore se, nëse kërkohet direkt në gjykatë nuliteti i aktit administrativ të organit tatimor që ngarkon subjektin tatimpagues me detyrime tatimore, gjykata e mban çështjen në juridiksion e saj gjyqësor, ndërkohë që objekt i gjykimit të çështjes nga gjykata janë dhe duhet të mbeten rigorozisht vetëm vërtetimi ose jo i njërit prej shkaqeve të parashikuara shprehimisht nga ligji për pavlefshmërinë absolute të aktit administrativ, si p.sh. ato nenit 116 të Kodit të Procedurës Administrative në lidhje edhe me respektimin ose jo nga organi administrativ të kompetencave, kushtet e procedurat që parashikohen nga ligje të posaçme për nxjerrjen e aktit administrativ që kundërshtohet direkt në gjykatë, psh. nenet 106, 107, të ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

Nëse në përfundim të shqyrtimit gjyqësor nuk rezulton e provuar nuliteti i aktit administrativ dhe ligji i posaçëm parashikon rrugë administrative të detyrueshme ankimimi, atëherë gjykata nuk vendos rrëzimin e padisë, por e nxjerr çështjen jashtë juridiksionit gjyqësor, madje edhe nëse nga rrethanat e çështjes do të rezultonte, se mund të cenohej ai akt administrativ për shkaqe të lidhura me pavlefshmërinë relative të aktit, argumentim i cili mbahet parasysh nga ky Kolegji në trajtimin e kësaj çështje. Kolegji çmon të drejtë përfundimin e gjykatës në vendim për pabazueshmëri të pretendimit të paditësit se vendimi nr. _____, datë 04.01.2013 i të paditurit Drejtoria e Apelitit Tatimor për

refuzimin e ankimit është dhënë në kundërshtim me ligjin. Sipas paditësit subjekti nuk ka detyrim të parapaguajë kamatëvonesat pas datës së njoftim vlerësimit tatimor, referuar kjo nenit 110/2 të ligjit dhe pikës 110.2 të Udhëzimit nr.24 datë 02.09.2008. Ndërsa Drejtoria e Apelit Tatimor ka mbështetur refuzimin e ankimit në vendimin nr.4 datë 30.05.2011 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, vendim i cili në kundërshtim të hapur me procedurat tatimore kërkon pagesën e kamatëvonesave deri në datën e likuidimit të detyrimit tatimor (08.10.2012) dhe jo në datën e njoftim vlerësimit (10.09.2012). Në këtë vendim Kolegjet e Bashkuara shprehen se:

"Dallohet qartësia në ligj që për tu marrë në shqyrtim ankimi detyrimisht duhet që të parapaguhet sipas aktit administrativ njoftim vlerësimit detyrimi tatimor, i cili duhet të ketë te përfshirë tatimin dhe kamatëvonesat. Mospagimi i tyre përpara paraqitjes së ankimit administrativ, kundër njoftim vlerësimit, passjell mosshqyrtimin e ankimit" dhe se "Tatimi i papaguar dhe kamatëvonesat e krijuara janë pjesë dhe përbëjnë "detyrimin tatimor", i cili duhet të paguhet përpara fillimit të procedurave të ankimit administrativ.

Për rrjedhojë, kërkimi i paditësit për kundërshtimin e vendimit nr._____, datë 04.01.2013 të Drejtorisë së Apelit Tatimor për shkak se ka vendosur refuzimin e ankimit si të papranueshëm është i pabazuar. Kolegji vëren të theksojë, se në rastin në gjykim shkak ligjor i padisë rezulton të jetë kundërshtimi i detyrimeve vendosur me një akt absolutisht të pavlefshëm, i cili pavarësisht disponimit të organit më të lartë administrativ nuk përbën shkak për bazueshmërinë ose jo të këtij pretendimi dhe efektet juridike të tij në rast pranimi të këtij pretendimi.

Kolegji Administrativ çmon të drejtë përfundimin e gjykatës së njoftim vlerësimi tatimor nr. _____, datë 10.09.2012, është nxjerrë në përputhje me ligjin nga organi kompetent, në përfundim të procedurave kryer në përputhje me ligjin nr. 9920/2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar dhe akteve nënligjore nxjerrë në zbatim të tij.

Gjykata Administrative e Apelit, në të kundërt sa parashtrohet nga paditësi, nuk çmon se jemi përpara ndonjë shkak të pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ përcaktuar në nenin 116 të K.Pr. Administrative.

Bazuar në këtë cilësim të fakteve gjyqësore të çështjes, Gjykata Administrative e Apelit çmon se, lidhur me çështjen duhet të vendosë në kushtet e nenit 50 shkronja "d" të ligjit 49/2012 sipas të cilit Gjykata Administrative e Apelit në dhomë këshillimi vendos:

d) Prishjen e vendimit dhe pushimin e gjykimit të çështjes në rastet kur çështja nuk hyn në juridiksionin gjyqësor, si dhe kur padia nuk mund të ngrihej ose gjykimi nuk mund të vazhdonte.

Pala paditëse ka ushtruar Rekurs në Gjykatën e Lartë.

Vlerësimi i Gjykatës së Lartë:

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë çmon të nevojshme të theksojë qëndrimin e mbajtur për shkak të disa ndryshimeve thelbësore që ka pësuar legjislacioni procedural, nga momenti kur Gjykata Administrative e Apelit ka marrë vendimin dhe momentin kur pala e paditur ka ushtruar rekursin në Gjykatën e Lartë (*shih vendimin nr. 00–2020-50, datë 27.05.2020 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë*). Pra nga ana e Kolegjit Administrativ është vlerësuar si e domosdoshme analiza mbi ligjin e zbatueshëm, të cilit do të duhet t'i referohet për të zgjidhur mosmarrëveshjen administrative, në rastin në shqyrtim.

Kolegji vlerëson se rekursi i palës së paditur, Shoqëria “K.A” sh.p.k., kundër vendimit nr.1769 datë 13.05.2014 të Gjykatës Administrative të Apelit nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr.49 datë 03.05.2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

Kolegji konkludon se, të gjitha shkaqeve të parashtruara në rekurs i është dhënë përgjigje në mënyrë shteruese nga të dy gjykatat e faktit, duke i bërë një analizë të hollësishme dispozitave të ligjit nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar si dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, Udhëzimi i Ministrit të Financave nr.24 datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të cilat rregullojnë mosmarrëveshjen në gjykim. Këto qëndrime bazohen edhe në jurisprudencën e Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë. Kolegji sjell në vëmendje se pjesa e pretendimeve në rekurs që ngre çështje të vlerësimit të provave, del jashtë juridiksionit rishikues dhe ekskluzivisht ligjor të Gjykatës së Lartë. Nëpërmjet rekursit dhe gjykimit në Gjykatën e Lartë nuk mund të pretendohet të rihapet edhe një herë shqyrtimi gjyqësor i provave. Për këtë fazë të gjykimit, shqyrtimi gjyqësor është i mbyllur dhe prekluzohet pas shqyrtimit të çështjes në Gjykatën e Apelit.

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë arrin në përfundimin se, rekursi i paraqitur ndaj vendimit nr. 1769, datë 13.05.2014, të Gjykatës Administrative të Apelit nuk duhet të pranohet.

Vendimi i Gjykatës:

- *Mospranimin e Rekursit të paditësit Shoqëria “K.A” sh.p.k.*

2. Vendim nr. 278, datë 12.05.2021

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë

Paditës: Shoqëria “D.K” sh.p.k.

Të paditur: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
Drejtoria e Apelimit Tatimor
Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë
Drejtoria e Kontrollit Tatimor

Objekti:

1. Shfuqizimin e Njoftim Vlerësimit të DRT Tiranë me nr._____, datë 07.07.2016;
2. Shfuqizimin e Vendimit të Drejtorisë së Apelimit Tatimor nr._____, datë 03.11.2016

Shuma e detyrimit tatimor: 1 686 655 Lekë.

Përmbledhje e Fakteve:

Shoqëria “D.K” shpk është kontrolluar nga DRT Tiranë, në zbatim të njoftim kontrollit nr.____ prot, datë _____ dhe programin e kontrollit bashkëlidhur tij për periudhat tatimore:

- “Për TVSH-në” periudha 01.09.2013 - 31.12.2015;
- “Për Sigurimet shoqërore dhe shëndetsore” 01.09.2013 - 31.12.2015;
- “Tatimi mbi fitimin” 2013 dhe 2014.

Në përfundim të kontrollit, është mbajtur raporti i kontrollit ku janë përshkruar shkeljet e konstatuara gjatë tij. Nga kontrolli i pasqyrave financiare të vitit 2014 është konstatuar se kosto e mallrave të shitur në bilanc është në shumën 78.077.167 Lekë, e cila përbëhet nga kosto e mallrave të shitur për shitjet me faturë tatimore në shumën 66.832.802 Lekë, e analizuar si më poshtë:

Gjendje fillim periudhe 45.360.694 Lekë;
Blerje gjatë periudhës 79.045.892 Lekë;
Gjendje fund periudhe 57.573.784 Lekë;
KMSH 66.832.802 Lekë.

Ndërkohë nga ana e shoqërisë është kaluar dhe në shpenzime, kosto e mallrave të rivlerësuara nga ana e kontrollit të mëparshëm në shumën 11.244.365 Lekë, duke i ngarkuar pa të drejtë shpenzime për këtë shumë, e cila në zbatim të Ligjit nr.8438 dt.28.12.1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, neni 21, nga ana e kontrollit do të klasifikohet shpenzim i panjohur dhe shoqërisë i lind një detyrim për tatimin mbi fitimin në shumën 1.685.655 Lekë.

Duke mos qenë dakord me këtë detyrim, shoqëria i është drejtuar me ankin administrativ, Drejtorisë së Apelimit Tatimor.

Drejtoria e Apelimit Tatimor me vendimin e saj nr._____ prot., datë 3.011.2016 ka vendosur “Lënien në fuqi të aktit administrativ Njoftim Vlerësimi nr._____ prot., datë 7.07.2016 të DRT

Tiranë”.

Kundër këtij vendimi, shoqëria ka ngritur padi pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, e cila me Vendimin nr.1236 dt.27.03.2017 ka vendosur:

- *“Rrëzimin e kërkesëpadisë së palës paditëse Shoqëria “D.K” sh.p.k.”*

Kundër këtij vendimi është ushtruar e drejta e ankimit nga ana e palës paditëse në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.

Vlerësimi i Gjykatës:

Zhvillimi i gjykimit në shkallë të parë por edhe në apel vërtetoi se shoqëria paditëse ka deklaruar në shpenzime dhe koston e mallrave të rivlerësuar nga kontrolli i mëparshëm në shumën 11.244.365 Lekë. Përfundimet e këtij kontrolli, finalizuar me njoftim vlerësimin e detyrimeve tatimore nr.____ prot., datë 05.11.2014 pala paditëse i ka bërë objekt shqyrtimi gjyqësor, i cili ka përfunduar pa zgjidhje përfundimtare.

Pra, as në rrugë administrative dhe as në rrugë gjyqësore nuk është deklaruar i pavlefshëm/ i paligjshëm njoftim vlerësimi i detyrimeve tatimore nr.____ prot., datë 5.11.2014 nxjerrë nga DRT Tiranë. Ndërkohë në këtë gjykim, rezulton se po këtë vlerë (11.244.365), pala paditëse e ka përfshirë dhe në gjendjen e inventarit në fund të periudhës tatimore.

Referuar veprimeve të kryera në kontabilitet nga shoqëria, rezulton se vlera 11.244.365 lekë është përfshirë në koston e mallit të shitur gjatë periudhës, edhe në gjendjen inventari. Në këtë mënyrë nga ana e Shoqërisë “D.K” shpk janë dubluar veprimet kontabël, veprim i cili bie ndesh me të gjitha parimet e kontabilitetit. Në momentin kur një vlerë përcaktohet si kosto e mallit të shitur, nuk mund të jetë dhe gjendje inventari, pasi kosto e mallit të shitur nënkupton shpenzimet e kryera për një mall të shitur.

Nga hetimi gjyqësor rezultoi se grupi i kontrollit ka zbatuar të gjithë legjislacionin tatimor, duke mos shkaktuar mangësi të procedurës së kontrollit të realizuar.

Veprimet e palës paditëse janë të gabuara pasi nuk mund të kontabilizohet njëkohësisht dhe në shpenzime dhe në gjendje inventari e njëjta vlerë. Këto gabime kanë passjellë dhe penalizimin me të drejtë të shoqërisë nga ana e administratës tatimore.

Vendim:

- Lënien në fuqi të vendimit nr.1236, datë 27.03.2017, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

3. Vendim nr.80-2021-743, datë 17.03.2021

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë

Paditës: “U.E” shpk

Të paditur: Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë
Drejtoria e Apelimit Tatimor

Objekti:

- Shfuqizimin e aktit administrativ “Njoftim Vlerësimi për detyrimet tatimore nr.____Prot., datë 23.07.2020 i Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, për gjoba në vlerën totale 277.236 lekë.
- Shfuqizimin e aktit administrativ “Vendim i Drejtorisë së Apelimit Tatimor” njoftuar me shkresën me nr. _____ Prot., datë 26.10.2020, i cili ka lënë në fuqi njoftim vlerësimin për detyrimet tatimore nr.____ Prot., datë 23.07.2020, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë.

Shuma e detyrimit tatimor: 277.236 lekë;

Permbledhje e Fakteve:

Paditësi “U.E” shpk me NIPT _____ është subjekt në administrimin e DRT Tiranë. Në rastin konkret nga punonjësit e autorizuar të administratës tatimore, bazuar në urdhrin e punës nr.____ prot, datë 30.06.2020, është ushtruar kontroll në subjektin ‘U.E’ me NIPT _____.

Shoqëria “U.E” është ngarkuar me detyrime tatimore nëpërmjet njoftim vlerësimit nr.____ Prot., datë 23.07.2020. Vlerësimi tatimor është rrjedhojë e akt-konstatimit me nr._____, datë 02.07.2020 dhe procesverbalit të gjobës me nr. _____, datë 02.07.2020. Sipas akt konstatimit rezulton se nga punonjësit e autorizuar të administratës tatimore, bazuar në urdhrin e punës nr.____ prot, datë 30.06.2020 është ushtruar kontroll në subjektin ‘U.E’ me NIPT _____ në adresën _____. Sipas akt konstatimit nga kontrolli i kryer ka rezultuar se:

“Subjekti është i regjistruar në QKB dhe organin tatimor me NIPT _____ dhe nuk paraqiti dokumentacion për regjistrim adrese dytësore ose vërtetim nga organet tatimore për regjistrim të mjetit me targa _____. Subjekti në këtë adresë ushtron veprimtarinë e transportit.

Në punë u gjet F.U me ID _____ me pozicion shofer, i cili nuk është i deklaruar në organin tatimor. Subjekti nuk disponon dokumentacion tatimor për mallrat që i ruan dhe transporton si në vijim:

- 1.Dyshek tek+jorgan sasia 2 në vlerën totale 40.000 lekë,
2. Jorgan sasia 1*5.100 lekë,
3. Shtrat shtange sasia 1*12.800 lekë,

4. Set çelësash mekanik 1*7.460 lekë

5. Amortizator mekanike 2 copë me vlerë totale 8.056 lekë. Vlera totale e mallrave 73.416 lekë.

Subjekti nuk disponon në vendbiznes dokumentacion tatimor, bllok 'Faturë tatimore shitje', për të kryer autofaturën për mallrat e pashoqëruar me dokumentacion tatimor.

Si rrjedhojë me procesverbalin e gjobës me nr. _____, datë 02.07.2020 tatimpaguesi është sanksionuar me gjobë për mospërditësimin e të dhënave për mjetin me targa _____, në shumën 15.000 lekë, bazuar në ligjin nr.9920/2008 i ndryshuar, neni 112.

Me procesverbalin e gjobës me nr. _____, datë 02.07.2020 tatimpaguesi është sanksionuar me gjobë për punëmarrës të padeklaruar, në shumën 200.000 lekë, bazuar në ligjin nr.9920/2008 i ndryshuar, neni 119, pika 1, gërma a).

Me procesverbalin e gjobës me nr. _____, datë 02.07.2020 tatimpaguesi është sanksionuar me gjobë TVSH për mallrat e pa dokumentuara me faturë tatimore në shumën 12.236 lekë, bazuar në ligjin nr.9920/2008, i ndryshuar, neni 124, pika 1.

Me procesverbalin e gjobës nr.294800, datë 02.07.2020, tatimpaguesi është sanksionuar me gjobë për mosmbajtje dokumentacioni (bllokun e faturave), në shumën 50.000 lekë, bazuar në ligjin nr.9920/2008, i ndryshuar, neni 118, njoftuar me njoftim vlerësimin e sipërcituar.

Shoqëria "U.E" shpk ka kundërshtuar gjobat e vendosura duke bërë ankim administrativ tek Drejtoria e Apelimit Tatimor. Drejtoria e Apelimit Tatimor pasi ka marrë në shqyrtim kërkesën, ka vendosur me vendimin nr. _____ Prot., datë 26.10.2020, lënien në fuqi të aktit administrativ njoftim vlerësimi me nr. _____ Prot., datë 23.07.2020. Duke e konsideruar vendimin e Drejtorisë së Apelimit Tatimor të pambështetur në prova dhe ligj, tatimpaguesi "U.E" shpk i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me kërkesëpadi.

Vlerësimi i Gjykatës:

Gjykata çmon se aktet administrative objekt gjykimi janë nxjerrë nga ana e organit administrativ pasi strukturat përkthënë të administratës tatimore konform attributeve që u njeh ligji kanë ushtruar kontroll. Gjatë këtij kontrolli kanë ndëshkuar palën paditëse sepse gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij janë konstatuar kundërvajtje administrative, si rrjedhojë me procesverbal gjobe me nr.294797, dt.02.07.2020, tatimpaguesi është sanksionuar me gjobë për mospërditësimin e të dhënave për mjetin me targa _____, në shumën 15.000 lekë, bazuar në ligjin 9920/2008 i ndryshuar, neni 112; me procesverbal gjobe nr. _____, datë 02.07.2020, tatimpaguesi është sanksionuar me gjobë për punëmarrës të padeklaruar në shumën 200.000 lekë, bazuar në nenin 119, pika 1, germa a); me procesverbal gjobe me nr. _____, datë 02.07.2020, tatimpaguesi është sanksionuar me gjobë TVSH për mallrat e padokumentuara me faturë tatimore, në shumën 12.236 lekë, bazuar në nenin 124, pika 1; me procesverbal gjobe me nr. _____, dt.02.07.2020, tatimpaguesi është sanksionuar me gjobë për

mosmbajtje dokumentacioni (bllokun e faturave) në shumën 50.000 lekë, bazuar në nenin 118. Të gjitha detyrimet e mësipërme janë njoftuar me njoftim vlerësimin me nr. ____ Prot., datë 23.07.2020, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë.

Lidhur me sanksionimin me gjobë për mospërditësimin e të dhënave të QKB në shumën 15.000 lekë, Gjykata analizon dhe vlerëson se detyrimi i tatimpaguesit për deklarimin dhe përditësimin e të dhënave, përfshirë edhe mjetin, buron nga neni 43 i ligjit nr.9920/2008. Pika 43.4.3 e udhëzimit nr.24/2008 parashikon se “Për mjetet e transportit të mallrave, qëllimi i lëvizjes së të cilëve është shitja derë më derë, mjetet e transportit të mallrave, si dhe mjetet e transportit të udhëtarëve që i përkasin personave të regjistruar për kryerje aktiviteti transport mallrash apo udhëtarësh, duke u konsideruar adresa ku personi i tatueshëm ushtron veprimtarinë e tij, si dokument vërtetues i përkatësisë së mjetit është Certifikata e Regjistrimit të Personit të Tatueshëm, me numër të ndryshëm serial (ose quajtur ndryshe “NIPT-i sekondar”), e lëshuar për çdo mjet që kryen veprimtari në të tilla kushte”. Paditësi nuk arriti të provonte se, në momentin e kontrollit nga grupi i kontrollit tatimor, në datën 02.07.2020 mjeti me targa ____ku është ushtruar kontrolli, ka qenë i pajisur me dokumentacionin e duhur sipas përcaktimeve në pikën 43.4 të udhëzimit nr.24/2008. Për rrjedhojë Gjykata vlerëson se penalizimi me gjobë prej 15.000 lekë është i drejtë, i ligjshëm e për pasojë duhet lënë në fuqi.

Lidhur me sanksionimin me gjobë për punëmarrës të padeklaruar Gjykata arsyeton se, nëpërmjet dënimeve ligjvënësi ka patur për qëllim detyrimin e tatimpaguesve që të deklarojnë punëmarrësit e tyre pranë organeve tatimore përpara fillimit të punës dhe më tej të llogarisin, mbajnë dhe derdhin në buxhetin e shtetit kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe tatimin mbi të ardhurat personale. Dënimi me gjobë sipas përcaktimeve në nenin 119 të ligjit nr.9920/2008, për cdo punonjës të padeklaruar vendoset në kushtet e flagrancës, kur gjatë kontrolleve të ushtruara në ambientet e ushtrimit të aktivitetit konstatohet që tatimpaguesi nuk ka deklaruar përpara kontrollit punëmarrësin e ri. Pala paditëse ka patur detyrimin për deklarimin dhe përfshirjen në skemën e kontributeve në përputhje me sa është përcaktuar në dispozitat në fuqi. Pala paditëse nuk e ka përmbushur këtë detyrim ligjor për punonjësën e konstatuar në punë në momentin e kontrollit e për rrjedhojë sanksionimi me gjobë në shumën 200.000 lekë sipas nenit 119, pika 1, gërma a), të ligjit nr.9920/2008, vlerësohet i drejtë e për pasojë duhet lënë në fuqi.

Lidhur me gjobën e TVSH-së për mallrat e padokumentuar me faturë tatimore, në shumën 12.236 lekë, bazuar në nenin 124, pika 1, të ligjit 9920/2008, Gjykata analizon se bazuar në nenin 121, pika 1, gërma (b), të ligjit 9920/2008, paditësi ka detyrimin ligjor që për mallrat në ruajtje, përdorim ose transport duhet t'i ketë të shoqëruara me faturë tatimore. Referuar akt-konstatimit nr.____, datë 02.07.2020, subjekti në mjetin me targa ____nuk disponon dokumentacion tatimor për mallrat që i ruan dhe transporton. Gjykata konstaton se, referuar aktit të kontrollit, ky i fundit është ushtruar në subjektin “U.E” i cili kishte në ruajtje dhe transportonte mallra të pashoqëruara me dokumentacionin tatimor përkatës. Pika 50.7 e udhëzimit nr. 24/2008 parashikon se, kur transporti i mallrave kryhet nga palë të treat, lëvizja e mallit shoqërohet me faturën e shitjes së mallit, ku ka të dhëna edhe për

transportuesin dhe datën e transportit. Për mallrat e pashoqëruara me faturë tatimore subjekti detyrohet të dokumentojë mallin duke lëshuar faturë tatimore sipas nenit 53 të ligjit 9920/2008 dhe mallit i kryhet rivlerësim i shitjeve në të njëjtin vlerë me vlerën e tregut të mallit të padokumentuar dhe aplikohet dënim sipas pikës 1 të nenit 124 të ligjit 9920/2008. Pala paditëse nuk e ka përmbushur këtë detyrim dhe për pasojë sanksionimi me gjobë vlerësohet i drejtë.

Lidhur me sanksionimin me gjobë në shumën 50.000 lekë, për mosmbajtje dokumentacioni në vendbiznes, referuar akt-konstatimit me nr.____, datë 02.07.2020, shoqëria nuk disponon dokumentacionin tatimor bllok me tvsh për të dokumentuar mallin pa dokumentacion për të cilën është mbajtur dhe proces-verbal gjobe me nr.____, datë 02.07.2020. Nga kontrolli dhe verifikimi në vend është konstatuar se nuk është përmbushur detyrimi ligjor lidhur me mbajtjen e dokumentacionit tatimor dhe transportimi i mallit të pashoqëruar me dokumentacion tatimor. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se me të drejtë paditësi është sanksionuar me gjobë.

Gjykata në analizë të kuadrit ligjor si më sipër konstaton se, nga ana e palës së paditur janë nxjerrë akte administrative të ligjshme të cilat pasqyrojnë gjendjen faktike, e cila u riprodhua para gjykatës nëpërmjet provave të analizuara. Për pasojë, penalizimi i paditësit nëpërmjet aktit administrativ objekt gjykimi është i ligjshëm dhe si i tillë duhet lënë në fuqi. Kjo pasi gjatë kontrollit ka rezultuar se paditësi ushtron aktivitet ekonomik dhe nuk ka bërë përditësim për mjetin me targa ____, është konstatuar në punë shtetasi F.U me pozicion shofer, i cili nuk është i deklaruar në organin tatimor, nuk disponon dokumentacion tatimor për mallrat që i ruan dhe transporton, në vlerë totale prej 73.416 lekë, si dhe nuk disponon në vendbiznes dokumentacion tatimor, bllok “Faturë tatimore shitje”, për të kryer autofaturën për mallrat e pashoqëruar me dokumentacion tatimor. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e rrëzon padinë dhe e konsideron të drejtë dënimin e palës paditëse.

Vendimi i Gjykatës:

- Rrëzim i kërkesëpadisë.

4. Vendim nr. 556 (86-2021-675), datë 10.11.2021

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë

Paditës: Shoqëria “P” sh.p.k,

Të paditur: Drejtoria Rajonale Tatimore Gjirokastrë,
Drejtoria e Apelit Tatimor,
Drejtoria e Përgjithshme të Tatimeve,

Objekti:

1. Shfuqizimin tërësisht të Njoftim Vlerësimit për detyrimet tatimore nr. _____, datë 10.03.2016, në vlerën 500.000 lekë, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Gjirokastrë.
2. Shfuqizimin tërësisht të Vendimit nr. _____ Prot., datë 06.07.2016, të Drejtorisë së Apelit Tatimor.

Shuma e detyrimit tatimor: 500.000 lekë.

Përmbledhje e fakteve:

Në zbatim të urdhrimit të punës nr. _____ prot., datë 07.09.2015, është ushtruar kontroll nga inspektorët e Drejtorisë Rajonale Tatimore Gjirokastrë, në vendin e ushtrimit të veprimtarisë nga subjekti paditës. Në përfundim të verifikimit në vend është mbajtur akt-konstatimi nr. _____, datë 22.09.2015, ku rezulton se në momentin e kontrollit në subjekt u gjendën: A.P, A.K, Xh.K, A. D.

Duke qenë se ky subjekt ushtron aktivitet në juridiksionin territorial të Drejtorisë Rajonale Tatimore Gjirokastrë, akt-konstatimi nr. _____, datë 22.09.2015, është përcjellë pranë Drejtorisë së Vlerësimit të të Ardhurave Tatimore dhe Kontabilitetit për të kryer verifikimet e punëmarrësve në listëpagesat e deklaruara nga vetë subjekti. Pas verifikimeve të kryera në sistemin informatik tatimor C@TS, ka rezultuar se një nga personat e gjetur në punë gjatë ushtrimit të kontrollit, konkretisht shtetasi A.D nuk rezultonte i deklaruar si i punësuar pranë subjektit paditës. Kjo pasi paditësi e kishte deklaruar të larguar nga puna që nga data 31.08.2015, nëpërmjet deklaratës E-SIG 027 “Deklarata e të punësuarve për herë të parë, atyre rishtazi si dhe e të larguarve nga puna” nr. ___, datë 04.09.2015. Ndërkohë që një ditë pas konstatimit të kryer nga grupi i kontrollit, paditësi ka kryer deklarinimin për punonjësin A.D, nëpërmjet deklaratës E-SIG 027 “Pasqyra e të punësuarve për herë të parë, atyre rishtazi si dhe e të larguarve nga puna” nr. ___, në datën 23.09.2015.

Në vijim të procedurës nga Drejtoria e Vlerësimit të të Ardhurave Tatimore dhe Kontabilitetit, është mbajtur Akt-Vlerësimi datë 10.03.2016, për pasqyrimin e situatës dhe është hartuar akti administrativ Njoftim-Vlerësimi për detyrimet nr. _____ Prot., datë 25.03.2016, për penalizimin e subjektit me gjobë në shumën 500.000 lekë, për punonjës të padeklaruar në zbatim të nenit 119, pika 1, shkronja a), të ligjit nr.9920, datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Duke mos qenë dakord me detyrimin e lindur ndaj organit tatimor, paditësi ka ushtruar të drejtën e tij për ankim administrativ ndaj Njoftim Vlerësimit për detyrimet nr. _____ Prot., datë 25.03.2016, në Drejtorinë e Apelit Tatimor Tiranë.

Pas shqyrtimit administrativ të ankimit nga kjo Drejtoria, me vendimin nr. _____ Prot., datë 06.07.2016, është vendosur: “Lënia në fuqi e aktit administrativ, objekt ankimi Njoftim Vlerësimi për

detyrimet tatimore nr. _____ Prot., datë 25.03.2016, lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Gjirokastrë, gjobë për punëmarrës të padeklaruar në shumën 500.000 lekë dhe rrëzimin e ankimit”.

Vlerësimi i Gjykatës:

Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se, shkaqet e ngritura në ankimin e palës së paditur DRT Gjirokastrë janë të mbështetura në prova dhe në ligj. Për rrjedhojë vendimi nr.579, datë 06.10.2016, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë, duhet të ndryshohet dhe të rrëzohet kërkesëpapia si e pambështetur në prova dhe në ligj.

Pala e paditur DRT Gjirokastrë, nëpërmjet shkaqeve të ankimit të sipërcituara, në thelb, parashtron se aktet administrative të kundërshtuara nga pala paditëse janë nxjerrë në zbatim dhe në përputhje me parashikimet e ligjit nr.9920/2008, të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 24/2008, si dhe të akteve të tjera ligjore e nënligjore në zbatim të tyre. Këto akte janë nxjerrë si rezultat i akt konstatimit me nr. _____, datë 22.09.2015, të mbajtur nga grupi i kontrollit të palës së paditur DRT Gjirokastrë. Kontrolli është ushtruar në vendin e ushtrimit të veprimtarisë së paditësit dhe në momentin e kontrollit në punë ka qenë edhe shtetasi A.D. Pas verifikimeve të mëtejshme në listëpagesat e deklaruara nga vetë subjekti paditës, ka rezultuar se ky punonjës nuk rezultonte i deklaruar në organin tatimor si i punësuar pranë palës paditëse, por ishte deklaruar i larguar nga puna. Ndërsa deklarimi i ripunësimit të tij është bërë një ditë pas konstatimit të faktit nga grupi i kontrollit të palës së paditur DRT Gjirokastrë. Pala paditëse nuk ka bërë asnjë sqarim dhe kundërshtim lidhur me situatën e pretenduar, për shtetasin A.D të gjetur në punë në momentin e kontrollit. Kjo nënkupton se paditësi ka rënë dakord dhe ka pranuar se akt konstatimi me nr. _____, datë 22.09.2015, është akt i hartuar në përputhje me ligjin dhe evidenton saktë situatën që ka ekzistuar në momentin e kontrollit.

Gjykata Administrative e Apelit, pas shqyrtimit të akteve procedurale dhe provave që përmban dosja gjyqësore, në zbatim dhe interpretim të drejtë të ligjit dhe fakteve të provuara në gjykim, vlerëson se aktet administrative të nxjerra nga palët e paditura DRT Gjirokastrë dhe DAT Tiranë janë të mbështetura si në ligjin material, ashtu edhe në atë procedural.

Në të tilla rrethana të faktit, rezulton e provuar që pala paditëse “P” sh.p.k ka vepruar në shkelje të detyrimeve të parashikuara në ligj për deklarimin e punonjësve që punësohen pranë subjektit tatimor dhe derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, deklarim i cili duhet të bëhet së paku një ditë përpara se punonjësi i ri të punësohet pranë atij subjekti tatimor.

Për rrjedhojë, nga ana e palës së paditur DRT Gjirokastrë është vepruar në zbatim të ligjit, duke aplikuar ndaj subjektit dënim administrativ me gjobë në shumën 500.000 lekë sipas sanksioneve që parashikon për këtë qëllim neni 119, pika 1, shkronja “a)”, e ligjit nr.9920/2008, i ndryshuar.

Bazuar në vlerësimin dhe arsyetimin e parashtruar më sipër në këtë vendim, Gjykata Administrative e Apelit vjen në përfundimin se vendimi nr.579, date 06.10.2016, i Gjykatës

Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë, duhet të ndryshohet dhe të rrëzohet kërkesëpapia si e pambështetur në prova dhe në ligj.

Vendimi i Gjykatës:

- Ndryshimin e vendimit nr.579, datë 06.10.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë.
- Rrëzimin e padisë.

5. Vendim nr. 377, datë 24.06.2021

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë

Paditës: “M.A” shpk,

Të paditur: Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës,
Drejtoria e Apelit Tatimor

Objekti:

Shfuqizimin e aktit administrativ Njoftim Vlerësimi nr.____ Prot., datë 11.05.2015, të DRT Durrës dhe Vendimit Nr.____ Prot, datë 08.01.2016, të DAT Tiranë.

Shuma e detyrimit tatimor: 1,000,000 lekë

Përmbledhje e Fakteve:

Pala paditëse ushtron aktivitet në qytetin e Durrësit, në të njëjtin ambient ku ushtron aktivitet shoqëria “F” shpk dhe të dyja shoqëritë kanë të njëjtin administrator. Nga ana e inspektorëve të DRT Durrës është ushtruar kontroll nga strukturat e Verifikimit në Terren, pranë palës paditëse, nga ku rezulton se dy shtetase, përgjegjëse për shërbimet e pastrimit, nuk janë të deklaruara ne Listëpagesën e shoqërisë M.A shpk. Nga ana e Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës, pas verifikimit të Listëpagesave si dhe deklaratave E-sig 027, është lëshuar Njoftim Vlerësimi nr.____ Prot., datë 11.05.2015, për shumën 1.000.000 lekë, për dy punonjëse të pasiguruara. Pala paditëse ka kundërshtuar aktin administrativ pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, me pretendimin se për aq kohë sa të dyja shoqëritë rezultojnë me të njëjtin administrator dhe ushtrojnë aktivitet në të njëjtin ambient, fakti që punonjëset janë të siguruara në njërin nga këto shoqëri (Shoqërinë “F” 2006), passjell që penalizimi nga ana e strukturave të administratës tatimore është i pabazë, pasi nuk jemi përballë kushteve të fshehjes dhe mosdeklarimit të punonjësve.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës, pas shqyrtimit të pretendimeve të palëve, me vendimin Nr.345, datë 19.04.2016, ka vendosur: “Pranimin e padisë dhe shfuqizimin e aktit administrativ objekt gjykimi”, vendim ndaj të cilit DRT Durrës, ka paraqitur ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.

Vlerësimi i Gjykatës:

Gjykata Administrative e Apelit, pasi shqyrtoi ankimin e paraqitur nga pala e paditur DRT Durrës, si dhe analizoi materialet e dosjes gjyqësore, konkludoi se vlerësimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës është i pasaktë, për faktin se po t’i referohemi parashikimeve ligjore në fuqi, vërehet se si nga ana e ligjit per procedurat tatimore, ashtu dhe ligjit per kontributet e detyrueshme, nuk ka ndonjë parashikim shterues që të përcaktojë mosdeklarimin e punonjësve në më shumë se një punëdhënës, për aq kohë sa shërbimi i kryer ose puna efektive, kryhet në më shumë se një tatimpagues. Në rastin objekt gjykimi rezulton se kontrolli është ushtruar në ambientet e tatimpaguesit M.A shpk, dhe nga ana e strukturave të administratës tatimore është verifikuar se në këto ambiente, rezultonin të punësuar, pra duke ofruar punën efektive dhe shtetaset e cituara në Akt Konstatimin e mbajtur. Për pasojë, Gjykata Administrative e Apelit konstaton se pranimi i padisë nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës është nje aplikim jo i drejtë i parashikimeve të ligjit nr.9920/2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” dhe si i tillë duhet të ndryshohet.

Vendimi i Gjykatës:

-Ndryshimin e Vendimit Nr.345, datë 19.04.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës.

-Rrëzimin e padisë.

6. Vendim nr. 432, datë 17.09.2021

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë

Paditës: T.SH

I paditur: Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës

Objekti: Shfuqizimin e aktit administrativ Njoftim Vlerësimi nr._____, datë 16.03.2016, të DRT-Durrës.

Shuma e detyrimit tatimor: 406,413 lekë

Përmbledhje e Fakteve:

Paditësi T.SH i regjistruar si person fizik me NIPT _____, ushtron aktivitetin e tij në qytetin e Durrësit. Në këtë tatimpagues është ushtruar kontroll nga Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës, në zbatim të njoftim kontrollit nr. _____ Prot., datë 09.02.2016, me objekt TVSH 01/2011-12/2015, tatim i thjeshtuar, tatim mbi te ardhurat personale, sigurime etj.

Në përfundim të kontrollit DRT Durrës ka lëshuar Njoftim Vlerësimin nr. _____ Prot., datë 16.03.2016, nga ku ka rezultuar se paditësit i linden detyrime në shumën 406,413 lekë.

Ky akt administrativ nuk është ankimuar në DAT Tiranë nga tatimpaguesi, po është kërkuar para Gjykatës konstatimi i pavlefshmërisë absolute, duke pretenduar se kemi shkelje flagrante të ligjit, që lidhen me procedurën e nxjerrjes së aktit, por duke paraqitur në kërkesëpadi argumenta dhe pretendime që lidhen me natyrën e pavlefshmërisë relative dhe jo atë absolute.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës, me vendimin Nr.916, datë 24.10.2016, ka vendosur:

- Rrëzimin e Padisë.

Më tej, pala paditëse T.SH ka ushtruar të drejtën e ankimit ndaj vendimit nr.916, datë 24.10.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës.

Vlerësimi i Gjykatës:

Gjykata Administrative e Apelit, ka arsyetuar si më poshtë:

Në lidhje me kushtet e pranueshmërisë së ankimit ndaj vendimit nr. 916, datë 24.10.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, motivet e kërtimeve në kërkesëpadi, parashtrimet e pretendimeve dhe kërkimet përfundimtare si dhe arsyetimit në vendimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, vlerëson se ekzistojnë kushtet e papranueshmërisë së ankimit referuar nenit 45 të ligjit 49/2012 “ Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” ku përcaktohen Vendimet e paankimueshme:

Nuk lejohet ankim ndaj vendimeve përfundimtare të gjykatës administrative për padi me objekt:

a) kundërshtimin e dënimit për kryerjen e kundërvajtjeve administrative, me vlerë më të vogël se njëzetfishi i pagës minimale, në shkallë vendi.

Ndërkohe, po ti referohemi pretendimeve të palës paditëse në kërkesëpadi, nuk arrihet te provohet se realisht kemi elemente të pavlefshmërisë absolute, të cilat bëjnë aktin administrativ nul, pasi të gjitha pretendimet e palës paditëse, paraqiten të natyrës së pavlefshmërisë relative dhe jo asaj absolute. Për pasojë Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se Vendimi Nr.916, datë 24.10.2016, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës është sipas legjislacionit në fuqi.

Vendimi i Gjykatës:

1. Mospranimin e ankimit kundër vendimit nr.916, datë 24.10.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës.
2. Lënien në Fuqi të Vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës.
3. Kundër këtij vendimi nuk lejohet rekurs në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë.

7. Vendim Nr.550, datë 10.11.2021

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë

Paditës: “A.F” shpk,

Të paditur: Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës,
Drejtoria e Apelit Tatimor (DAT)

Objekti: - Konstatimin e pavlefshmerise absolute të akteve administrative:
- Njoftim Vlerësimi Nr. _____ Prot., 30.10.2015, të DRT Durrës
- Vendimin Nr. _____ Prot., datë 26.01.2016 të DAT Tiranë
- Vendimin Nr. _____ Prot., datë 22.01.2016 të DAT Tiranë

Shuma e detyrimit tatimor: 1,792,750 lekë

Përmbledhje e Fakteve:

Pala paditëse ushtron aktivitet në qytetin e Durrësit, i regjistruar në organet tatimore me NIPT _____. Nga ana e Administratës Tatimore është ushtruar kontroll nga strukturat e Hetimit Tatimor, pranë palës paditëse, nga ku rezultoi se tatimpaguesi disponon në ambientet e ushtrimit të aktivitetit një pajisje jofiskale, e cila është sekuestruar dhe depozituar për analizim pranë DRT Durrës.

Mbi bazen e ekspertizës së pajisjes jofiskale, ka rezultuar se ka diferenca nga deklaratimet e bëra nga paditësi në Administratën Tatimore dhe asaj çfarë evidentohet në pajisjen jofiskale, për pasojë nga DRT Durrës është urdhëri i kontrollit, ku në përfundim të cilit është hartuar akti përkatës si dhe Njoftim Vlerësimi nr. _____ Prot., datë 30.10.2015, mbi bazën e të cilit, tatimpaguesit i njoftohen detyrime në masën 1.792.750 lekë. Pala paditëse ka depozituar dy ankime administrative pranë DAT, por në të dy rastet ky organ nëpërmjet Vendimeve nr. _____ Prot., datë 26.01.2016 dhe nr. _____ Prot., datë 22.01.2016, ka vendosur refuzimin e ankimit, pasi paditësi nuk ka paguar shumën e detyrimit objekt shqyrtimi.

Më tej, pala paditëse ka kundërshtuar aktet administrative pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, me pretendimin se në nxjerrjen e aktit administrativ si dhe procedurën e ndjekur për analizimin e pajisjes jofiskale si dhe mbajtjes së kontrollit të DRT Durrës, kemi elemente të pavlefshmërisë absolute, në lidhje me procedurën, gabime të pretenduara, të cilat e kthejnë aktin administrativ në nulitet.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës, pas shqyrtimit të pretendimeve të palëve, me vendimin nr.687, datë 11.07.2016, ka vendosur: “Rrëzimin e padisë si të pabazuar në ligj”.

Vlerësimi i Gjykatës:

Gjykata Administrative e Apelit, pasi shqyrtoi ankimin e paraqitur nga pala paditëse si dhe analizoi materialet e dosjes gjyqësore, konkludon se vlerësimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, është i saktë, për faktin se referuar kerkimeve të paraqitura nga ana e palës paditëse në kërkesëpadi por dhe në ankim, vërehet se objekti i padisë pretendon, ekzistencën e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ. Në këto raste gjykata limitohet vetëm në identifikimin e ekzistences ose jo të atyre elementeve të mirëpërcaktuar në ligj, të cilët e kthejnë aktin administrativ në nulitet duke bërë që ky i fundit të përbëjë një shkelje flagrante të Kodit të Procedurës Administrative dhe legjislacionit material. Në rastin objekt shqyrtimi evidentohet se pretendimet e palës paditëse janë të natyrës së pavlefshmërisë relative të aktit, pasi kundërshtojnë mënyrën e aplikimit të ligjit material tatimor dhe jo të natyrës së pavlefshmërisë absolute, kritere të cilat, paraqiten në formë të qartë dhe shtruese në KPA.

Vendimi i Gjykatës:

-Lënien në fuqi të vendimit nr.687, datë 11.07.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës.

- Rrëzimin e padisë.

8. Vendim nr. 466, datë 29.09.2021

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë

Paditës: Shoqëria “Y” sh.p.k

Të Paditur: Drejtoria Rajonale e Tatimeve Vlorë

Drejtoria e Apelimit Tatimor (DAT)

Objekti:

1. Kundërshtim i Procesverbal-Gjobë me nr. _____, datë 28.08.2015, i DRT Vlorë, i njoftim

vlerësimit tatimor nr. ____Prot., datë 02.09.2015, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Vlorë dhe i vendimit nr. ____Prot., datë 08.01.2016, të Drejtorisë së Apelit Tatimor.

2. Marrjen e masës së sigurimit të padisë, pezullimin e zbatimit të aktit administrativ urdhër bllokimi i llogarive bankare nr. _____, datë 22.02.2016, lëshuar nga DRT Vlorë.

Shuma e detyrimit tatimor: 2,000,000 lekë

Përmbledhje e Fakteve:

Ndaj subjektit “Y” sh.p.k me NIPT _____, inspektorët e Sektorit të Verifikimit në Terren të DHT kanë ushtruar një kontroll në ambientet e subjektit në bazë të Urdhërit të Shërbimit nr. _____ Prot., datë 26.03.2015. Mbi bazën e kontrollit të ushtruar në shoqërinë “Y” sh.p.k janë mbajtur Akt-Konstatimet me nr.serial _____ datë 27.03.2015, ku rezultoi se: *“...subjekti ushtron aktivitet i regjistruar në organin tatimor. Në momentin e kontrollit në orën orën 10:40 deri në orën 12:30 në vendin e punës janë gjetur gjithësej 26 (njëzet e gjashtë) punonjës përfaqësuar nga znj. O.C me dokument identifikimi _____”.*

Akt konstatimet e mbajtura nga ana e inspektorëve të DHT, janë përcjellë për zbatim të mëtejshëm në DRT Vlorë. Inspektori i dosjes ka bërë verifikimet në SIT sistemin tatimor C@TS (i listëpagesave si dhe E-SIG027) i deklarimeve të bëra nga subjekti dhe ka rezultuar se punonjësit M. L, L. H, L.V, Xh.H, nuk janë deklaruar si punonjës pranë organeve tatimore në momentin e kontrollit.

Në bazë të konstatimit të mbajtur është mbajtur dhe Proces-Verbal Gjore me nr. serial _____, datë 28.08.2015, ku në bazë të ligjit 9920 “Për Procedurat Tatimore në RSH” (i ndryshuar), duke ju referuar po nenit 119, pika 1, gërma (a), subjekti është penalizuar me gjobë 2.000.000 (dy milion) lekë, për katër punonjës të padeklaruar në organet tatimore.

Për këto penalitete subjekti është njoftuar nëpërmjet Njoftim Vlerësimit nr. ____Prot., datë 02.09.2015, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Vlorë.

Vlerësimi i Gjykatës:

Gjykata Administrative e Apelit gjatë arsyetimit të saj është ndalur mbi procedurën që duhet të ndjekin palët për kryerjen e ankimit.

Gjithashtu, është verifikuar dhe është konstatuar prej kësaj gjykate se nëpërmjet padisë janë vënë në diskutim vendimet e organeve tatimore dhe konkretisht: Proces Verbal Gjore me nr. _____, datë 28.08.2015 i DRT Vlorë, njoftim vlerësimit tatimor nr. ____ prot, datë 02.09.2015 të Drejtorisë Rajonale Tatimore Vlorë dhe vendimi nr. ____prot, datë 08.01.2016, të Drejtorisë së Apelit Tatimor, të cilat nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë janë konsideruar të vlefshme duke rrëzuar në këtë mënyrë kërkesëpadinë.

Gjykata Administrative e Apelit është ndalur dhe tek parashtrimet që paditësi ka bërë gjatë ankimit ku janë konstatuar dhe shkaqe të cilat nuk lidhen me tre vendimet objekt padie dhe me kërkimet e paditësit gjatë gjykimit në shkallë të parë, duke i tërhequr vëmendjen paditësit mbi faktin se objekt i padisë së shqyrtuar me vendimin e ankimuar nuk ka qenë Urdhër Bllokimi nr. _____, datë 22.02.2016, por tre akte administrative të disponuara nga organet tatimore.

Urdhër Bllokimi nr. _____ Prot., datë 22.02.2016, rezulton të ketë qenë i lidhur me kërkimin dytësor të paditësit, ngritur gjatë gjykimit në shkallë të parë e që konsistonte në marrjen e masës së sigurimit të padisë, nëpërmjet pezullimit të këtij urdhri. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë rezulton të ketë disponuar me vendimin e ndërmjetëm datë 28.04.2016 që konsiston në rrëzimin e kërkesës për marrje mase sigurimi padie, duke mos pezulluar ekzekutimin e Urdhër Bllokimit nr. _____ prot, datë 22.02.2016.

Gjykata Administrative e Apelit ka arsyetuar se shkaqet e ngritura në ankimin e palës paditëse lidhur me Urdhër Bllokimin nr. _____ prot, datë 22.02.2016, do të duhej të ishin ngritur vetëm si shkaqe të ankimit të saj të vecantë kundër vendimit të ndërmjetëm të Gjykatës për rrëzimin e kërkesës për marrje mase sigurimi padie. Në rastin konkret, nuk është objekt shqyrtimi vendimi i ndërmjetëm i gjykatës së shkallës së parë disponuar në lidhje me kërkimin për marrje mase sigurimi padie por është disponimi i kësaj gjykate mbi themelin e padisë, dallim të cilin pala paditëse nuk e reflekton në ankimin e saj.

Gjithashtu, është arsyetuar nga Gjykata Administrative e Apelit se pala paditëse ka qenë e pranishme në seancën përgatitore të datës 19.05.2016 në përfundim të të cilës është kaluar çështja në seancë gjyqësore datë 02.06.2016 dhe paraqitjen prej palëve ndërgjyqëse të provave në dobi të gjykimit, tre ditë para datës së seancës gjyqësore, duke paralajmëruar njëherësh se, mosrespektimi i këtij afati do të përbënte shkak për mospranimin e këtyre provave. Në seancën e parë dhe të fundit gjyqësore data 02.06.2016, pala paditëse nuk është paraqitur, duke mos paraqitur as shkaqe që përlligjin mos paraqitjen dhe nuk rezulton të ketë dorëzuar aktet provuese tre ditë para seancës gjyqësore.

Për këtë shkak, gjykata e shkallës së parë rezulton të ketë disponuar me vendimin e ndërmjetëm për zhvillimin e gjykimit në mungesë të palës paditëse, duke disponuar në përfundim të seancës gjyqësore, me vendimin përfundimtar për rrëzimin e padisë.

Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se vendimmarrja e gjykatës së shkallës së parë nuk reflekton shkelje në lidhje me procedurën e zhvillimit të gjykimit dhe ka vlerësuar se ankimi i palës paditëse (lidhur me Urdhër Bllokimin) nuk përbën shkak për ndryshimin në favor të saj të vendimit të gjykatës së shkallës së parë (lidhur me Procesverbal gjobën, njoftim vlerësimin dhe vendimin e DAT-së).

Vendimi i Gjykatës:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 902, datë 02.06.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.

2. Rrëzimin e kërkesëpadisë.

9. Vendim Nr. 406, datë 14.07.2021

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë

Paditës: “F.A” sh.a me NIPT _____

Të Paditur: Drejtoria Rajonale e Tatimeve Vlorë

Drejtoria e Apelimit Tatimor (DAT)

Objekti:

1. Pavlefshmëri e shkresës “Njoftim Vlerësimi” me nr. _____, datë 07.12.2015, të DRT Vlorë.
2. Shfuqizimi i vendimit nr. _____prot, datë 10.03.2016, i Drejtorisë së Apelimit Tatimor.
3. Deklarimin e shuarjes së detyrimit sipas shkresës “Njoftim Vlerësimi” me nr. _____, datë 07.12.2015, të DRT Vlorë.

Shuma e detyrimit tatimor: 569,015 lekë

Përmbledhje e Fakteve:

Shoqëria “F.A” sh.a me NIPT _____, është njoftuar nga DRT Vlorë me aktin administrativ Njoftim Vlerësimi nr. _____ Prot., datë 07.02.2015, se për periudhat 2015/6, 2015/7, 2015/8, 2015/9, 2015/10 subjekti është penalizuar me gjobë në vlerën 569.015 lekë pasi ka të papaguara detyrimet për periudhat si më sipër të specifikuar në kamatvonesa dhe gjoba.

Pala paditëse pretendon se nga ana e saj janë kryer të gjitha pagesat konform të gjitha detyrimeve të saj në bankën CREDINS. Këto penalitete janë llogaritur për llojin e tatimit “Tatim mbi lojërat e fatit”, për periudhën 2015/06. Për këtë periudhë kohore nga ana e palës paditëse pranë Credins Bank në datën 09.07.2015 është paguar kjo faturë referuar “Urdhër Xhirimit Bankar”. Në këtë datë është shlyer plotësisht detyrimi ndaj DRT Vlorë duke e derdhur në buxhet detyrimin përkatës.

Sa më sipër, nga inspektori i Sektorit të Përpunimit të Deklaratave, Vlerësimit dhe Rimbursimit në datën 13.11.2015 është mbajtur Akt Verifikimi nr. _____ Prot, datë 23.11.2015, ku është cituar se: “... në lidhje me kërkesën e subjektit F.A sh.a me nr. _____ Prot, datë 23.10.2015 për sistemim të pagesave të kryera nga subjekti për taksën e aparateve për periudhën 2015.06, subjekti ka paguar në kohë gjithë detyrimet për pagesën e taksës së aparateve për periudhën 2015/06, por kjo pagesë gabimisht ka kaluar Sig. Shoqërore po për këtë periudhë 2015/06, kryesisht shuma e taksës është në

vlerën 5.900.000 lekë ka kaluar me kodin e sigurimeve shoqërore (1900) në këtë vlerë për këtë shumë subjekti del kreditor për sigurimet shoqërore për periudhën 2015/06 dhe debitor për taksë aparatesh për periudhën 2015/06. Të bëhet rimbursimi për sigurimet shoqërore dhe të kalojnë për detyrimet e taksës së aparateve. Mbahet akt verifikimi për sistemim të këtyre detyrimeve”.

Ky gabim ka ardhur nga veprimi i kryer nga një punonjëse e bankës Credins e cila gabimisht e ka kaluar pagesën për Lojrat e Fatit për periudhën 2016/06 me kodin e Sig. Shoqërore (1900) po për këtë periudhë 2016/06, detyrimi për Lojrat e Fatit për këtë periudhë pranë organeve tatimore rezulton se është paguar me vonesë dhe si rrjedhojë subjekti është penalizuar për pagesë të vonuar në organet tatimore. Mospagesa e detyrimit brenda afatit pasjell gjenerimin nga sistemi tatimor të gjobave dhe pagesave. Hedhja gabimisht e pagesës është bërë nga ana e Banks Credins dhe jo nga DRT Vlorë. Nga ana e DRT Vlorë janë zbatuar të gjitha procedurat ligjore konform Ligjit 9920 datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në RSH” i ndryshuar.

Vlerësimi i Gjykatës:

Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se shkaqet e ngritura në ankim nga DRT Vlorë nuk janë të mbështetura në prova e në ligj, për rrjedhojë vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë duhet të mbetet në fuqi me argumentin si më poshtë: Palët e paditura e kanë zbatuar gabim ligjin kur kanë vlerësuar se pala paditëse “F.A” sh.a ka kryer në vonesë, pra jashtë afateve ligjore, pagesën e detyrimeve tatimore, duke e ngarkuar për këtë motiv me detyrime për të paguar kamatëvonesa si edhe gjobë për mospagim në afat të detyrimit tatimor për veprimtarinë e lojërave të fatit. Pala paditëse “F.A” sh.a nuk mund të ngarkohet me asnjë përgjegjësi ligjore administrative për gabimet njerëzore të kryera nga banka e cila ka devijuar shumë e autorizuar shprehimisht nga paditësi tatimpagues për pagimin e detyrimit tatimor për lojrat e fatit në detyrime për sigurimet shoqërore. Në raste të tilla tatimpaguesi nuk mund të konsiderohet në vonesë për shlyerjen e detyrimit, duke u ngarkuar edhe me shlyerje të kamatëvonesave përkatëse, përderisa mënyra elektronike e pagesës nëpërmjet bankës është e parashikuar nga ligji dhe subjekti tatimpagues ka urdhëruar dhe autorizuar bankën të kryejë pagesën në shumë dhe për llojin e detyrimit tatimor të kërkuar nga vetë organi tatimor.

Në rrethana të tilla të mungesës së përgjegjësisë dhe fajësisë, tatimpaguesi nuk mund të ndëshkohet me gjobë për kryerje të një kundërvajtje administrative. Dënim edhe administrativ, në mungesë të anës subjektive të fajësisë nuk mund të ketë. Vlerësimi i sistemit informatik “C@ts” nuk mund të prevalojë në asnjë rast mbi ligjin. Sistemet informatike ngrihen, bazohen dhe i shërbejnë zbatimit të ligjit por ato nuk mund të diktojnë dhe të zëvendësojnë ligjin.

Vendimi i Gjykatës:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 2156, datë 22.12.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.
2. Pranimin e kërkesëpadisë.

10. Vendim nr.355, datë 20.09.2021

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë

Paditës: T.H

I paditur: Drejtoria Rajonale Tatimore Sarandë

Objekti:

Pezullimin dhe kundërshtimin e Urdhrit nr. _____, datë 30.01.2020 (Për bllokim bankar) ndaj ish subjektit X sh.p.k me NIPT_____.

Shuma e detyrimit tatimor: 1,639,800 lekë.

Përmbledhje e fakteve:

Paditësi T.H i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë me kërkesëpadinë me objekt: Pezullimin dhe kundërshtimin e Urdhrit nr._____ datë 30.01.2020 (Për bllokim bankar) ndaj ish subjektit “X” sh.p.k me NIPT _____.

Shkresa nr._____, datë 30.01.2020, Urdhër për bllokimin e llogarive bankare për tatimpaguesin “X” sh.p.k me NIPT _____, me administrator T.H (në periudhën kur është nxjerrë kjo shkresë), është nxjerrë nga Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara në DRT Sarandë, si vijimësi e procedurave të mbledhjes me forcë të detyrimit tatimor të papaguar që kishte kjo shoqëri.

Detyrimet perkatësisht në zërin TVSH, Tatim mbi Fitimin, Sigurime Shoqërore e Shëndetësore, Tatim i Mbajtur në Burim, TAP, ishin detyrime të cilat ishin vetëdeklaruar dhe nuk ishin paguar ose nuk ishin paguar në afat nga ky tatimpagues, dhe për të cilat tatimpaguesi nuk kishte ushtruar ankim as në rrugë administrative as në rrugë gjyqësore dhe si pasojë DRT Sarandë kishte vijuar me procedurat e mbledhjes me forcë të detyrimeve tatimore të papaguara ndaj këtij tatimpaguesi. Më datë 09.03.2020 në QKB është depozituar Kontrata e Shitjes të 100% të kuotave të shoqërisë nga ortaku T.H në favor të S.H, kontratë e cila mban datën 04.12.2015, si dhe është ndryshuar administrator, ku është larguar administrator T.H dhe është emëruar administrator S.H. Këto ndryshime në QKB janë pasqyruar më datë 09.03.2020, pra pas nxjerrjes së shkresës objekt kundërshtimi në rrugë gjyqësore nr._____ datë 30.01.2020 “Urdhër për bllokimin e llogarive bankare” të nxjerrë nga DRT Sarandë. Pasi është njohur me këtë fakt nga ana e DRT Sarandë janë kryer procedurat e mëtejshme ligjore duke vijuar më mbledhjen me forcë të detyrimit tatimor ndaj tatimpaguesit “X” sh.p.k me administratorin e ndryshuar S.H.

Megjithatë paditësi T.H, duke mos pasur më asnjë lidhje me subjektin “X” sh.p.k, pasi nuk kishte më

as tagër përfaqësimi, kundërshtoi në rrugë gjyqësore Urdhërin nr. _____ datë 30.01.2020 “Për bllokimin e llogarive bankare” të nxjerrë për tatimpaguesin”X”.

Kjo çështje u gjykua nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë, e cila ka arritur në vlerësimin si më poshtë:

Vlerësimi i Gjykatës:

Së pari, gjykata ka verifikuar faktin nëse paditësi gëzon legjitimitet aktiv në ngritjen e kësaj kërkesëpadie dhe ka vlerësuar se paditësi T.H nuk gëzon legjitimitet aktiv pasi shkresa e palës së paditur Urdhëri nr. _____ datë 30.01.2020 “Për bllokim bankar” është nxjerrë kundrejt personit juridik shoqërisë “X” me NIPT _____, të organizuar si shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar dhe jo kundrejt individit T.H.

Së dyti, kjo gjykatë vlerëson se shkresa nr. _____, datë 30.01.2020 “Urdhër për bllokim bankar” nuk mund të jetë objekt ankimi në rrugë gjyqësore. Vetë ligji ka përcaktuar se masat administrative që kanë të bëjnë me mbledhjen me forcë të detyrimit tatimor, nuk janë objekt ankimi, sepse kanë të bëjnë me mënyrën më të mirë të mbledhjes së detyrimeve tatimore.

Referuar sa më sipër, në gjykatë mund të kundërshtohet vetëm akti administrativ (individual apo nënligjor normativ) si dhe kontratat administrative dhe jo çdo shkresë e administratës.

Pra në rastin konkret ku pala paditëse kundërshton Urdhërin për bllokim bankar të nxjerrë nga DRT Sarandë kjo shkresë nuk përbën akt administrativ dhe nuk mund të bëhet objekt ankimi administrativ apo gjyqësor. Kjo shkresë nuk ka krijuar pasoja juridike dhe në rastin konkret jemi përpara një padie e cila nuk mund të ngrihet kundër shkresave që nuk kanë fuqinë e akteve administrativë individuale.

Gjithashtu kjo gjykatë ka vlerësuar se pretendimet e paditësit janë zgjidhur në rrugë administrative, pasi DRT Sarandë kur është vënë në dijeni të faktit të ndryshimit të administratorit të shoqërisë “X” si dhe të shitjes së kuotave të aksioneve, janë kryer veprimet duke bërë rregullimet përkatëse dhe duke bllokuar llogaritë e taimpaguesit “X” sh.p.k me administrator S.H.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë ka dalë në konkluzionin se nga ana e DRT Sarandë janë kryer të gjitha veprimet në përputhje të plotë me ligjin dhe nuk ka asnjë shkak ligjor dhe bazë ligjore në kërkimin e paditësit për pezullimin dhe kundërshtimin e Urdhërit nr. _____ datë 30.01.2020 “Për bllokim bankar” ndaj subjektit “X” sh.p.k me NIPT _____.

Vendimi i Gjykatës:

- Rrëzimin e kërkesëpadisë.
- Kundër këtij vendimi nuk ka paraqitur ankim pala paditëse, duke marrë formë të prerë vendimi nr.355 datë 20.09.2021, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë.

11. Vendim nr. 552, datë 10.11.2021

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë

Paditës: Drejtoria Rajonale e Tatimpaguesve të Mëdhenj (DTM)

I paditur: Drejtoria e Apelimit Tatimor (DAT)

Person i tretë: Shoqëria “Y”

Objekti: Anullimi i Vendimit të Drejtorisë së Apelimit Tatimor nr. _____ prot., datë 15.03.2016.

Shuma e detyrimit tatimor: 1,480,000 lekë

Përmbledhje e Fakteve:

Nga ana e DTM-së është bërë rivlerësim tatimor për shoqërinë “Y”, në zbatim të shkresës nr. _____ datë 14.10.2015 të dërguar nga Njësia e Mbikëqyrjes së Lojrave të Fatit (NJMLF), me të cilën përcillet informacioni për numrin e pikave të miratuara nga kjo e fundit për shoqërinë “Y”.

Duke iu referuar informacionit të përcjellë shoqëria ka të miratuara për muajin Korrik 2015 gjithësej 594 pika, ku nga rakordimi me deklarinimin e shoqërisë na rezulton se:

Pika të miratuara	Pika të deklaruara	Diferenca
Kategoria e parë 205 pika	kategoria e parë 183 pika	-22 pika
Kategoria e dytë 328 pika	kategoria e dytë 310 pika	-18 pika
Kategoria e tretë 61 pika	kategoria e tretë 58 pika	-3 pika

Nga sa rezulton me sipër janë deklaruar nga ana e shoqërisë 183 pika të kategorisë së parë, 310 të kategorisë së dytë dhe 58 pikë të kategorisë së tretë dhe, për të përfunduar procedura për këto pika është bërë rivlerësimi nga ana e DTM-së.

DTM me shkresën nr. _____ datë 08.10.2015 ka vënë në dijeni Njësien e Mbikëqyrjes së Lojrave të Fatit se, deklarinimet për bastet sportive për Shoqërinë “Y” për muajin korrik 2015 nuk rakordojnë me të dhënat për 551 pika sekondare në total, të ndara në kategori si me poshtë vijon:

Kategoria e parë 183 pika;

Kategoria e dytë 310 pika;

Kategoria e tretë 58 pika.

NJMLF në përgjigje të shkresës të sipërcituar sqaron se: “Nga verifikimi i hollësishëm i sistemit të të dhënave të NJMLF, rezulton se shoqëria “Y” sh.a për muajin Korrik 2015 ka të miratuar gjithësej 594 pika, nga të cilat 205 në kategorinë e parë, 328 në kategorinë e dytë dhe 61 në kategorinë e tretë.

Rezulton se kjo shoqëri nuk ka deklaruar 43 pika”.

Sa më sipër, rezulton se shoqëria “Y” nuk ka deklaruar 43 pika të cilat janë miratuar në muajin Korrik 2015 nga NJMLF dhe referuar Ligjit nr.10033 datë 11.12.2008 “Për Lojrat e Fatit”, pala paditese është gjobitur në bazë të deklarimeve për pikat e basteve që i përcillen DTM nga NJMLF. Në këto kushte është bërë rivlerësim tatimor ku nëpërmjet Njoftim Vlerësimit nr. _____, datë 08.10.2015 shoqëria është në masën 1.480.000 lekë.

Personi i tretë Shoqëria “Y” ka bërë ankim pranë Drejtorisë së Apelimit Tatimor ku ka ankimuar Njoftim Vlerësimit nr. _____ datë 18.11.2015 të lëshuar nga DTM.

Drejtoria e Apelimit pasi e ka marrë në shqyrtim kërkesën ankimore gjatë arsyetimit të vendimit pranon se ka një mosrakordim të pikave të deklaruara nga shoqëria dhe pikave sekondare të miratuara me një diferencë prej 43 pikash. Në këto kushte nga DTM është kryer rivlerësim tatimor. DAT e ka konsideruar të drejtë ankimin e shoqërisë dhe ka vendosur shfuqizimin e Njoftim Vlerësimit nr. _____, datë 18.11.2015.

Vlerësimi i Gjykatës:

Shoqëria nuk ka pasur detyrimin për të regjistruar në QKB pikat sekondare pasi ky detyrim i lind pasi ka kryer veprimet ligjore në lidhje me marrjen e miratimit nga NJMLF. Pas këtij momenti i ka lindur e drejta për t’u regjistruar në QKB. Nga DTM i bëhet me dije NJMLF se nuk rakordojnë të dhënat për 551 pika sekondare në total të ndara sipas kategorive përkatëse. Me shkresën nr. _____, datë 14.10.2015, NJMLF njofton palën paditese së shoqëria për deklaratimet e muajit Korrik 2015 nuk ka deklaruar 43 pika, të cilat janë miratuar në Korrik 2015. Shoqëria për hapjen e adresave sekondare ka njoftuar NJMLF para regjistrimit në QKB.

Gjithashtu, NJMLF me shkresën nr. 3573, datë 20.11.2015 drejtuar shoqërisë është shprehur se ligji nr. 10033, datë 11.12.2008, nuk ka parashikuar afat ligjor kur subjekti pas marrjes së miratimit për hapjen e adresave sekondare të jetë i detyruar të regjistrohet në QKB.

Vendimi i Gjykatës:

- Rrëzimi i padisë

12. Vendim nr.530, datë 03.11.2021

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë

Paditës: Drejtoria Rajonale e Tatimpaguesve të Mëdhenj (DTM)

I paditur: Drejtoria e Apelit Tatimor (DAT)

Person i tretë: Shoqëria “S.A”

Objekti: Anullimi pjesërisht i vendimit nr. _____ Prot., datë 22.12.2015, të Drejtorisë së Apelit Tatimor

Shuma e detyrimit tatimor: 45,000,000 lekë

Përmbledhje e fakteve:

Gjatë kryerjes së kontrollit në shoqërinë “S.A” shpk, për blerjet e deklaruara nga kjo shoqëri për vitin 2011 u konstatua se në muajin Mars 2011 është deklaruar si blerje me tvsh të zbritshme një faturë tatimore e cila nga ana e DTM konsiderohet si blerje që nuk është në përputhje me kërkesat ligjore të sistemit tatimor shqiptar, konkretisht fatura me nr.serie _____ datë 2.12.2010, me nr.fature ____, me vlerë të tatueshme 6,943.683 leke e tvsh e zbritshme 1.388.775 lekë me përshkrimin e shërbimit “shërbime konsulence ligjore” dhe shpenzime të tjera. Kompania që ka kryer këtë shërbim është shoqëria “X” shpk.

Kjo blerje konsiderohet si kreditim i parregullt i TVSH-së pasi është deklaruar në Mars 2011 dhe është kryer në Dhjetor të vitit 2010, kur aktiviteti i kompanisë është i deklaruar me zero, pra nuk konsiderohet se i ka shërbyer aktivitetit të shoqërisë.

Për sa më sipër, shoqërisë i bëhet rivlerësimi i situatës se TVSH-se në muajin Mars 2011 duke i pakësuar blerjet me tvsh të zbritshme për shumën 6.943,683 lekë vlerë e tvsh e zbritshme 1.388.735 lekë dhe njëkohësisht duke rritur blerjet pa tvsh për shumën 8.332.418 lekë.

Bazuar në nenin 41 të Ligjit nr.7928, datë 27.04.1995 “Për Tatimin Mbi Vlerën e Shtuar”, i ndryshuar, nenin 115 të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, pika 1, pas ndërhyrjes së kontrollit, shoqëria detyrohet të paguajë për muajin Mars 2011 TVSH 1.388.735 lekë, si dhe gjobë në vlerën 304.133 lekë.

Gjatë kontrollit në shoqërinë “S.A” sh.p.k për blerjet e deklaruara nga kjo shoqëri për vitin 2012 u konstatua se në honorare për të drejtat e autorit prej 43,707,641 Lekë u përlllogaritën nga totali i të ardhurave nga shitja dhe janë të pagueshme ndaj shoqërisë mëmë për të drejtat për të përdorur emrin tregtar, proceset e planifikimit dhe prodhimit si dhe në lidhje me informacione që kanë lidhje me eksperiencën tregtare dhe industriale përdorur gjatë vitit të mbyllur më 31 dhjetor 2012.

Nga kontrolli u shqyrtua ky lloj shpenzimi dhe u arrit në konkluzionin se nuk i shërben aktivitetit pasi emri i mirë nuk ndikon në asnjë komponent të xhiros që realizon shoqëria “S.A” shpk, pasi shërbimi që kryen kjo shoqëri në Shqipëri është një treg monopol i saj ku tarifata e kryerjes së prodhimit dhe shitjes së pullave fiskale janë të përcaktuara më parë.

Nga ana tjetër, duke qenë se shoqëria Zvicerane është aksionere 100% e shoqërisë “S.A” sh.p.k, kjo e fundit, nuk është në pozicionin e blerësit të një patente, të drejte përdorimi, marke etj,nga nje kompani e huaj, pra nuk ka arsye pse të paguajë një shpenzim të tillë, aq më tepër në % mbi xhiron e aktivitetit për emrin e mirë.

Veprimet e mësipërme nuk janë në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr.8436 datë 28.12.1998 (ndryshuar me ligjin nr. 9716 dt. 16.04.2007) neni 20 “shpenzime të njohura”... *Për përcaktimin e fitimit të tatueshëm në Republikën e Shqipërisë njihen si shpenzime ato që kryhen për qëllime fitimi, sigurimi dhe ruajtje të fitimit, në masën që këto shpenzime provohen dhe dokumentohen nga tatimpaguesi, si dhe kur janë objekt i kufizimeve të specifikuara nga ky ligj.*

Dokumenti i përdorur si bazë për justifikimin e shpenzimit, për efekt tatimor, është: fatura tatimore me TVSH, fatura e thjeshtë tatimore dhe çdo dokument tjetër i përpiluar dhe lëshuar, në përputhje me udhëzimet e Ministrit të Financave, në zbatim të legjislacionit tatimor.....”

Në mbështetje të ligjit Nr.8438 datë 28.12.1998 (ndryshuar me Ligj nr. 9844, datë 17.12.2007) neni 21 “shpenzime të panjohura pika 1: l) *çdo shpenzim, masa e të cilit nuk vërtetohet me dokumente nga tatimpaguesi; ll) shpenzimet për shërbime teknike, konsulence dhe të menaxhimit, të faturuara nga persona të tretë, për të cilat nuk është paguar tatimi në burim, brenda periudhës tatimore nga tatimpaguesi, shoqërisë i bëhet rivlerësimi i situatës së tatimit mbi të ardhurat sipas bilancit kontabël të vitit 2012 duke pakësuar shpenzimet e njohura për efekt të tatimit mbi të ardhurat për shumën 43.707.641 lekë dhe njëkohësisht duke rritur shpenzimet e pazbritshme për të njëjtën shumë (Ulja e humbjes 43.707.641 lekë).*

Vlerësimi i Gjykatës:

Pretendimi i paditësit për paligjshmëri të kreditimit është i pambështetur në ligj.

Vendimi i Gjykatës:

- Rrëzimi i padisë.